

BAHRI BECI

GRUPI PERËNDIMOR I NËNDIALEKSTIT VERIOR TË GEGËRISHTES¹

(Veçoritë dalluese)

Grupimi i të folmeve të gegërishtes ka tërhequr vëmendjen prej kohësh².

Kohët e fundit ky problem është trajtuar më gjerësisht në punimet e J. Gjinarit e A. V. Desnickajës³.

Në punimet e këtyre autorëve, me të drejtë, veçohet si një grup më vete grupi perëndimor i nëndialektit verior të gegërishtes (i quajtur prej tyre «gegërishte veriperëndimore» ose «grupi veriperëndimor i të folmeve gege»), i cili i kundërvihet grupit lindor të nëndialektit verior të gegërishtes (i quajtur prej tyre «gegërishte verilindore» ose grupi verilindor i të folmeve gege» ose «grupi verilindor gegë».

Janë bërë përpjekje dhe janë shënuar rezultate në përcaktimin e shtrirjes territoriale të këtij grupi të folmesh⁴, në zbulimin e veçorive të përbashkëta dalluese të tij⁵, në përcaktimin e nëngrupeve që e përbëjnë, si edhe të veçorive dalluese të tyre⁶.

Megjithatë gjendja e sotme e materialeve dhe e studimeve për këto të folme⁷ lejon të hidhet një dritë e re mbi këto probleme.

1) Emërtimin «grupi perëndimor i nëndialektit verior të gegërishtes» ne do ta përdorim rregullisht në vend të emërtimeve të përdorura gjer tani «grupi i gegërishtes veriperëndimore» (J. Gjinari, SF, 1966, 4, f. 110, 112), «nëndialekti i gegërishtes veriperëndimore» (J. Gjinari, Dialektologjia shqiptare, dispensë; 1963, f. 74). «grupi veriperëndimor i të folmeve gege» (A.V. Desnickaja, Albanskij jazyk i evo dialekty, Leningrad, 1968, f. 80).

Në ndryshimin e këtij emërtimi ne nisemi nga fakti që grupet e të folmeve ne i konceptojmë si njësi dialektore më të vogla në përbërjen e një nëndialekti dhe jo të dialektit. I parë nga kjo pikëpamje ky grup të folmesh zë një pozitë perëndimore në nëndialektin verior të gegërishtes. Mënyrimi i emërtimeve të përdorura gjer tani eviton mundësinë e përzierjes së nocioneve nëndialekt dhe grup të folmesh.

2) M. Lambertz, *Bericht über meine linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August, 1916*, në *Anzeiger der philos. hist. Kl. d. Akad. d. Wiss. in Wien*, 1916 Nr. XX f. 9. *Die Mundarten der albanischen Sprache und ihre Erforschung*, Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa, Bd. 7. H. 2-4, 1943, f. 129; *Die Mundarten der albanesischen Sprache*, Lehrgang des Albanischen, III, Halle (Saale), 1959, f. 13.

3) J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, dispensë, Tiranë 1963, f. 74, 76, *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, SF, 1966, 4, f. 110 (shih edhe botimin frëngjisht në: *Actes du premier congrès international des études balkaniques et sudest européennes*, VI, Sofia, 1963, f. 350).

A. V. Desnickaja, *Albanskij jazyk i evo dialekty*, Leningrad, 1968, f. 77.

4) M. Lambertz, Punime të cituara; J. Gjinari, Punime të cituara; A. V. Desnickaja, Punim i cituar.

5) E. Çabej, *Për nistorinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, BUSHT, SSHSH, 1958, 1, f. 31, 37, 51, 52; *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes* BUSHT, SSHSH, 1958, 3, f. 71, 78, 82, 85; J. Gjinari, *Dialektologjia...*, f. 76, *Sprovë...*, f. 112.

6) A.V. Desnickaja, *Vepër e cituar*, f. 77, 80-111.

7) Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kastratit*, SF, 1967, 2, f. 35-61; SF, 1967, 3, f. 47-

Në këtë artikull ne do përpigemi të ndriçojmë më tej dy prej tyre: 1) shtrirjen territoriale të këtij grupi të folmesh dhe 2) veçoritë dalluese të tij në fushën e fonetikës e të morfologjisë, pa pretenduar natyrisht për një zgjidhje përfundimtare të tyre. Veçoritë leksikore e sintaksore nuk do të bëhen objekt trajtimi për arsye se materialet janë ende të pamjaftueshme.

I. Përpjekjen e parë për veçimin e të folmeve perëndimore të nëndialektit verior të gegërishtes nga të folmet lindore të këtij nëndialekti e ka bërë M. Lamberci më 1916 në një relacion të tij të shkruar mbas një ekspedite të bërë në Shqipëri për qëllime linguistike dhe folkloristike⁸. Në këtë punim të Lamercit nuk flitet shprehimisht për të folme perëndimore të nëndialektit verior të gegërishtes, po për të folme të Malësisë. Ato kundërvihen me të folmet e Gjakovës dhe të Kosovës. Pra M. Lamberci, ndonëse jo të emërtuar me termat e sotëm, që më 1916 pranonte ekzistencën e një grupi lindor dhe të një grupi të Malësisë. Në këtë të fundit ai përfshinte edhe një pjesë të mirë të të folmeve të grupit lindor të nëndialektit verior të gegërishtes.

Në punimin e tij kundërvihen gjithashtu të folmet e Malësisë me të folmen e Shkodrës, duke e konsideruar këtë të fundit si një të folme më vete e origjinale. E folmja e Mirditës në këtë punim afrohet me të folmet e Lurës, Kthellës dhe Matit.

Më 1943 M. Lamberci e rimerr problemin e klasifikimit të të folmeve geqe⁹. Kësaj radhe e folmja e Malësisë quhet veriore (gegërishte veriore). Ajo i kundërvihet gegërishtes së quajtur prej tij lindore dhe gegërishtes së quajtur prej tij e mesme.

Në këtë punim jepet edhe shtrirja territoriale e grupit të të folmeve të quajtur prej tij «gegërishte veriore». Simbas Lamercit, ky grup të folmesh shtrihet në një territor, që fillon nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës deri në Gjakovë, nga Kelmendi në veri deri në Lezhë e Mat në jug. Lamberci në punimin e vitit 1943, ndryshe nga ato që shkruante më 1916, ka përfshirë edhe të folmen e Mirditës. Këtë mendim Lamberci e ka përsëritur edhe më 1959¹⁰.

Më 1963 J. Gjinari e çon më përpara çështjen e përcaktimit të shtrirjes territoriale të të folmeve perëndimore të nëndialektit verior të gegërishtes. Simbas J. Gjinarit ky grup të folmesh, i quajtur prej tij «gegërishtja veriperëndimore», shtrihet: në Shkodër, në Malësi të Madhe, në Dukagjin, në Zadrinë e në Mirditë¹¹.

Më 1966 J. Gjinari shënonte se kufiri që i ndan të folmet e këtij grupi me të folmet e quajtura prej tij verilindore kalon tek Thethi, duke

67; Vëzhgime rreth të folmeve të malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit, Lissus, Lezhë, 1967, f. 152-173; T. Osmani, *Shënime të fonetikës të së folmes së Shirokës*, Buletin shkencor, 1965, f. 373-385; *Shënime për të folmen e Shirokës*, Buletin shkencor, 1966, 5, f. 245-259; B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, punim i pabotuar; J. Kastrati, *Mbi disa tipare të së folmes së Thethit*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor 1962), Tiranë, 1965, f. 255-261.

Një burim me vlerë për të folmen e Dushmanit përbën punimi i W. Cimochovskit, *Le Dialecte de Dushmani*, Poznan, 1951. Në përcaktimin e veçorive të këtyre të folmeve ne do të kemi parasysh edhe materialet e grumbulluara nga ne në Theth e Lohe të Sipërme dhe në Pistull të Zadrinës nga V. Lohja.

8) M. Lambert, Bericht..., f. 9.

9) M. Lambert, *Die Mundarten...* 1943, f. 129.

10) M. Lambert, *Die Mundarten...*, f. 13.

11) J. Gjinari, *Dialektologjia...*, f. 76.

e lënë këtë në anën veriperëndimore, vazhdon pak më në lindje të lumit të Shalës, aty ku fillojnë tokat e Nikaj-Mërturit (e folmja e të cilit, simbas tij, është verilindore) dhe më poshtë vazhdon në të majtë të Drinit, ca në perëndim të Pukës¹². Këtë mendim ai e përsërit edhe më 1969¹³.

J. Gjinari në artikullin e 1966 me të drejtë shënonte se M. Lambersi në këtë grup të folmesh «përfshin edhe një numër të madh të folmesh verilindore, duke e shtrirë në Nikaj-Mërtur, Krasniqe, Has, Berish, Iballë, Qerret e Mal të Zi (nenv. B.B.)».

A. V. Desnickaja më 1968 gjithashtu dallonte në zonën veriore gege të folmet e grupit të quajtur prej saj veriperëndimor dhe të folmet e grupit verilindor. Në grupin veriperëndimor përfshinte: a) të folmen e malësorëve që banojnë në pjesën perëndimore të Alpeve veriore të Shqipërisë dhe në pjesën verilindore të pellgut të Liqenit të Shkodrës (kjo e folme, shënon ajo, mund të quhet e folmja e Malësisë së Madhe); b) të folmen e popullsisë shqiptare të krahinës së Krajës në Mal të Zi, (në perëndim të Liqenit të Shkodrës); c) të folmen e malësorëve të pjesës qendrore të Alpeve veriore të Shqipërisë dhe të pjesës së mesme të pellgut të Drinit të bashkuar (për këtë grup propozon termin «të folmet e Dukagjinit»); ç) të folmet e rrafshinave të rajoneve për rreth Shkodrës; d) të folmen qytetare të Shkodrës (në dy variantet e saj)¹⁴.

Nga sa pohohet edhe më poshtë, në atë punim bëhet e qartë që në këtë grup të folmesh hyjnë: të folmet e Malësisë së Madhe, të Krajës, të Dukagjinit (Shala, Shoshi, Pulti, Postriba, Mazrreku, Shllaku, Dushmani, Toplana, Puka (pjesa perëndimore e saj), të gropës së Shkodrës, të Shkodrës dhe të Zadrimes¹⁵.

Duhet shënuar se Desnickaja në këtë punim ka shprehur edhe një mendim tjetër të ndryshëm nga ai që u parashtrua më sipër. Ajo veçon si një grup më vete të ndryshëm nga grupi veriperëndimor e grupi verilindor të folmet e Dukagjinit¹⁶ që shtrihen në të dy anët e rrjedhjes së mesme të Drinit të bashkuar (Shala, Shoshi, Pulti, Postriba, Mazrreku, Shllaku, Dushmani, Toplana, Puka)¹⁷, të cilat në vendin e cituar më parë i përfshinte në të folmet e ashtuquajtura veriperëndimore, si pjesë përbërëse e tyre.

Dy autorët e fundit largohen prej njëri-tjetrit në qëndrimin që mbajnë lidhur me të folmen e Mirditës e të Pukës. J. Gjinari të folmen e Mirditës e përfshin në grupin e të folmeve perëndimore të nëndialektit verior të gegërishtes, kurse të folmen e Pukës në grupin e të folmeve lindore të nëndialektit verior të gegërishtes. Desnickaja, përkundrazi, të folmen e Mirditës e nxjerr jashtë nga grupi perëndimor kurse të folmen e Pukës e përfshin në këtë grup të folmesh (duke përfshijtur të folmen e Berishës, Bugjonit, Iballes e Malit të Zi, të cilat i përfshin në grupin lindor të nëndialektit verior të dialektit të veriut).

E. Çabej, duke u nisur nga forma (ti) *ra* (=re), të ndeshur në një këngë vaji prej Mirdite shkruan se kjo është një formë që flet për origjinën gege lindore të së folmes mirditore ku këndohet.¹⁸

12) J. Gjinari, *Sprovë...* f. 110.

13) J. Gjinari, *Kursi i dialektologjisë shqiptare*, Tiranë 1969, f. 71 (dispensë).

14) A. V. Desnickaja, *Punim i cituar*, f. 30.

15) A. V. Desnickaja, *Po aty*, f. 80-111. Për të folmen e Pukës shih f. 90, 121, 122; kurse për të folmen e Zadrimes f. 100-104.

16) A. V. Desnickaja, *Po aty*, f. 77.

17) A. V. Desnickaja, *Po aty*, f. 77.

18) E. Çabej, *Diftongje...*, f. 85.

Për të argumentuar me sukses shtrirjen territoriale të një grupi të folmesh është e nevojshme, në radhë të parë, të përcaktojmë veçoritë dalluese të tij dhe shtrirjen territoriale të tyre.

II. Përpjekjet për zbulimin e veçorive dalluese të të folmeve të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes nuk kanë mundur. Rezultatet që janë shënuar janë me interes dhe shërbejnë si një pikënisje për zgjidhjen e këtij problemi.

Një kontribut pozitiv kanë dhënë në këtë drejtim N. Jokli, E. Çabej, J. Gjinari e E. Lafe.

N. Jokli e E. Çabej, ndonëse nuk janë marrë direkt me këtë çështje, njohin si veçori karakteristike të këtij grupi: 1) Kalimin e bashkëtingëlloreve *q, gj* në afrikatet prepalatale *c', g'*, sidomos në elementin katolik; 2) kalimin e grupeve *kl, gl* respektivisht në *k-j, g-j*;¹⁹ 3) kalimin e grupeve të zanoreve *oe, ae*, respektivisht në *ô* dhe *ê* (të hapët)²⁰.

J. Gjinari më 1963 shënonte si veçori dalluese të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes këto:

1) *a* para bashkëtingëlloreve hundore ka dhënë *â* dhe nuk është zhvilluar më tej si në shumë të folme: *bân, kâm, nâna*; 2) *a'* e theksuar gojore në disa raste të kufizuara ndihet si një *a* më e përparme dhe e mbyllur, ka timbrin e një zanoreje që është ndërmjet *a-së* dhe *e-së* [*ã*]: *nâlt, prâp, zjârm*; 3) Veç Shkodrës, ku *ue, ye, ie* janë monoftonguar, në shumë të folme gjejmë sot togje zanoresh *ue, ye, ie*; sidomos më shumë në rrokje fundore të hapët; 4) togu i zanorve *ae* > *ä*: dhë (<dhæ), kurse toku *oe* > *o*: vö (<voe); 5) grupet e vjetër *kl, gl*, kanë përfunduar me *kî, gî; kîumsht, gîun*; 6) grupet *mb, nd, ng* janë asimiluar dhe kanë dhënë respektivisht: *m̄, n̄, η* (tinguj disi të zhurshëm: *m̄aj, m̄ush, n̄alon, hūna, ηref, Prēna*; 7) grupi *fsh* është thjeshtuar dhe ka dhënë *sh*: *shîjse, munash, kîosha*; 8) emrat fëmërorë njëjës në rasën rrjedhore të trajtës së shquar kanë dhe trajtën me *-et*: mish *lopet*; 9) disa plotësa të dallimit ndërtohen nga një emër në rasën rrjedhore të shquar: *mish viçit, mish lopet*.²¹

E. Lafe më 1964, duke dashur të përcaktojë vendin e të folmes së Nikaj-Mërturit në të folmet e gegërishtes, shënon si të përbashkëta me grupin perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes këto tipare të së folmes së Nikaj-Mërturit. 1) kontraktimin e togut zanor *ae*: *ê* te emri *ngê* dhe ndalimin e këtij kontraksioni nga epenteza e një *v*-je te trajta foljore *pave*; 2) asimilimin e grupit *fsh* > *sh*: kosh «kofshë», kosh me nder «qofsh me nder»; 3) përdorimin e mbaresës *-u* te emrat me *-k, -g* (bujku, zogu), dhe mbaresës *-i* te emrat me *h* (*ahi, krahi*) dhe përdorimin e mbaresës *-u* për vetën e parë njëjës të së tanishmes te foljet me temë me *-k, -g* (*hiku, pjeku, djegu, lagu*).

Ai shton gjithashtu se togu zanor *oe* në grupin perëndimor është kontraktuar me *ô*. Ky autor i njeh grupit perëndimor si veçori që dallon nga grupi lindor edhe ruajtjen e *a-së* para nazaleve (në grupin lindor kjo simbas tij, ka kaluar në *ô*)²².

19) N. Jokl, *Zur Erforschung der abanischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmazien*, Archivum Romanicum, vol. XXIV, 1940, f. 9, 10; *Slaven und Albaner*, Slavia, XVI, 2-3, f. 296; Slavia, XIII, 4, f. 622.

E. Çabej, *Për historinë...*, f. 31, 51.

20) N. Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Beriche des Albanischen*, 1923, f. 207.

E. Çabej, *Diftongje...*, f. 82.

21) J. Gjinari, *Dialektologjia...*, f. 76-77:

22) E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, SF 1964, 3, f. 136.

Më 1966 J. Gjinari e rimerr problemin dhë, në pajtim me pohimet e bëra më 1963, i njeh grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes si veçori dalluese 5 prej tyre: 1) kalimin e *ae* dhe *oe* respektivisht në *ä* (*a* e përparme e mbyllur) dhe *æ* (*e* e hapët e labializuar): *ñë* (ngae = nge), ti m *thä* (thae = the) dhe *væ* (*væ* = ve), (*væs* (vesë)); 2) kalimin e grupeve të vjetra *kl*, *gl* respektivisht në *kj* e *gj*: *kjumsht* (qumësht), *gjuni*, (gjuni), kalimin e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, respektivisht në bashkëtingëlloret disi të zhurmshme *m̄*, *n̄*, *ñ*: *m̄ushi*, *n̄alon*. *Prena*; 4) thjeshtimin e grupit *fs*h me *sh*: *shjse* (fshesë), *muñash* (mëndafsh), *kjçsha* (qofsha); 5) daljen e rrjedhores së emrave femërorë njëjës të snquar me *-et*: *mish lopet*²³.

Disa nga veçoritë dalluese të grupit perëndimor të sjella në punimin e 1963 në këtë punim janë lënë jashtë: 1) ruajtja e *a*-së së theksuar para nazaleve; 2) kalimi i *a*-së gojore të theksuar në disa fjalë në *ä*; 3) ruajtja e grupit të zanoreve *ue*, *ye*, *ie* në shumë të folme.

Nga këto që u thanë del se autorët e sipërpërmendur pajtohen me njëri-tjetrin në njohjen si veçori dalluese të grupit perëndimor të nëndialektit verior të këtyre tipareve: 1) të kalimit të grupeve të bashkëtingëlloreve *kl*, *gl*, respektivisht në *kj*, *gj*, 2) të kalimit të *ae* e *oe* respektivisht në *ë* (*ä*) dhe *ö* (*æ*).

J. Gjinari dhe E. Lafe pajtohen me njëri-tjetrin në njohjen si veçori dalluese të grupit perëndimor edhe të kalimit të grupit të bashkëtingëlloreve *fs*h në *sh*.

Duhet shënuar se E. Çabej dhe E. Lafe në punimet e tyre nuk i kanë vënë vetes si qëllim zbulimin e veçorive të grupit perëndimor, prandaj edhe lista e tipareve dalluese të këtij grupi të folmesh në punimet e tyre rrok vetëm një pjesë të tyre.

Duhet pranuar se në punimet e përmendura (me përjashtim të punimeve të E. Çabejt) kanë munguar përpjekjet për argumentimin e këtyre pohimeve me të dhëna konkrete nga të folmet e këtij grupi.

Duke i vështruar pohimet e bëra mbi veçoritë karakteristike të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes nën dritën e të dhënave të reja, rezultoi se nga ato që janë pranuar si veçori dalluese të këtij grupi të folmesh qëndrojnë, ndonëse me një vlerë jo të barabartë, këto:

1. *Kalimi i grupeve të bashkëtingëlloreve kl, gl, respektivisht në kj, g-j*. Ky fenomen është përhapur në të folmen e Thethit: me *kjajt* «me qa»; *n'kjoft* «n'qoftë». (J.K. v.c., f. 256-257), *kjan*, *kjoft*, *kjumsht*, *g-jû*, *nig-jon*, *g-juh*, e *g-jat*²⁴; në të folmen e Shkrelit: *kjûsht*, *skjep*, *kjaj*, *shkjan*, *kjeç*, *kje*, *kjen*, *kjosh*, *kjoft*, por me *ken*; (në Vrih, ndonëse rrallë, ka edhe *q* për *kl*: *qe* anku, *t'mos qofsha* fal, *ju qoft* fal burra); me *g-ja*, *g-jasën*, *g-jõb*, *g-jû*, *g-jûh*, *g-jût*, me *nig-ju*, *xg-jella*; në të folmen e Kastriotit: *kjumsht*, *kjumshtore*, *kjāj*; me *ckjarua*, *kjoft*; e *g-jata*, *g-juha*, *g-jat*, *g-jådrra*, *kryeg-jat*, *g-jataruç* (Gj. Sh. SF. 1967, 2, f. 43); në të folmen e Lohes së Sipërme: *kjeç*, *kje*, *kjeme*, *kjet*, *kjen*, *kjan*, *kjumsht*, *skjep*, *shkjepon*, *kjoft*; *g-jût*, *g-jû*, *g-juh*, *g-jõb*, *zg-jedh*, *nig-joj*; por *xgidh*; në të folmen e Dushmanit: *kjõft*, me *kjajt*; *g-juni*, i *g-jât* (W.C. v.c. f. 22); në të folmen e Shirokës: *kjumsht*, *kjoshum*, *shikju*, *kja*, *kjoft*, *kje*, por me *ken*; *g-jût*, *g-jûh*, *g-jûe*, *ndig-joj*. Tek elementi mysliman grupi *g-j* në

23) J. Gjinari, *Sprovë...* f. 112. Këto janë përsëritur nga autori edhe më 1969 në *Kursi i dialektologjisë shqiptare* (dispensë), Tiranë, 1969, f. 72-73.

24) Për materialet që janë mbledhur prej nesh në Theth, Lohe të Sipërme, Shkrel e Mirditë nuk do të jepen referimet përkatëse.

shumicën e fjalëve ka evoluar në *gj: gjuh*, kurse *g-juc* (T.O. v.c. 1965, f. 381); në elementin katolik të Shkodrës: *kjeç, kjaj, g-juh, g-juni, i g-jāt*, me *nig-ju*, por kam *ken, kish, gisht, zgidh*; në Zadrimë: *kjeç, kjaj, g-juh, g-juni, g-jāt* me *nig-ju*, por kam *ken, kish, groht, zgidh*.²⁵ Ky fenomen mungon në të folmen e Nikaj-Mërturit. Atje dëgjohen variantet *k, g* të *kl, gl*: me *kajt, kosh* me nder, *kumshti*, me *shkye*; i ka *gā babs, i gāt, gāndra, gob, t'gobiti, guha, gūni*, me *ndigue*, me *zgidh* (E.L. v.c. f. 115). Në të folmen e Pukës gjithashtu dëgjohen variantet *k, g* të grupeve të bashkëtingëlloreve *kl, gl*: *kaj, kumsht, kesh, ke, kem; guha, guni, goba; t'nigosh* etj.²⁶

Në të folmen e Mirditës grupet e bashkëtingëlloreve *kl, gl* janë palatalizuar respektivisht në bashkëtingëlloret mesgjuhore (palatale) *q, gj*: ka *qen (qâ°n), qumsht, qan, gjuha, gjuni, e zgjidha, gjōb*. Në Laç e Kaçinar *q (< kl) > q'*. Grupet *kl, gl* i kemi ndeshur vetëm tek fjalët *klish* (Munaz) dhe *glaska* (Thirrë).

2) Kalimi i grupit të zanoreve *ae* në *ç* (të hapët). Ky fenomen është i përhapur në Shkrel; *s'ko, ŋe, hç, m'pç, m-rç, m'lç, m'thç* në Kastrat: *hç-ja, gç-ja, ti pç, ti dhç, i thç, ti lç* (Gj. Sh. : SF, 1967, 2, f. 44); në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit që janë të ardhur nga Malësia e Madhe: *ge, ti thç, ti pç, ti rç, hç-ja* (Gj. Sh. Lissus, f. 161); në të folmen e Lohes së Sipërme: *thç, gç, hç, m'lç, m'rç*; në të folmen e Dushmanit: *hç*, (W.C. v.c. f. 7); në të folmen e Shkodrës: *hç, ŋç, m'pç, m'thç, m'lç*; në të folmen e Shirokës *ŋç* (T.O. v.c. 1965, f.7). Fenomeni është i përhapur edhe në të folmen e Nikaj-Mërturit: *ge, nge*, por *pave* (E.L. v.c. f. 113). Fenomeni mungon në Zadrimë: *ti tha, ti m'la, ti m'dha*, por *ti m'pave*. Në të folmen e Pukës *ae > ae, a° ose a* (ti) *dhae, hae, lae, thae*, por më shpesh *na*, (ti) *dha, haja*. Në të folmen e Mirditës *ae* zakonisht ruhet, në raste më të veçanta ajo dëgjohej si *a°* ose si *a*: (ti) *m'dhae, m'thae, m'lae, ae, hae, m'dhae, m'lae, m'dha*.

3. Përfundimi në *sh* i grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* në mënyrën dëshirore të foljeve me temë në zanore. Ky fenomen është i përhapur në Theth: *n'jesha* «ndjefsha» (J.K. v.c. f. 258); për t'mir e *shtroshi*, e *pishim* me ner; në Shkrel: *rrnosh, kjoshi, u miqsosh, t'kjosha* fal; në Kastrat: *kjosh, u shurdhosh, u verbosh, u tërbosh, shkosh* (Gj. Sh. SF, 1967, 2, f. 43); në Dushman: *basha, shkosha, thesha, kjosha, kjosh, kjoshim, kjoshi, kjoshin, punosha* (W.C. v.c. f. 115, 145, 147, 148); në Shirokë: *kjoshum* (T. O. v. c. 1965, f. 382), në Shkodër. Ky fenomen është i përhapur edhe në Nikaj-Mërtur: *u ndiesha* t'mirën, *kosh* me nder, *u shurdhosh* etj. (E.L. v.c. f. 116) e Pukë: *mos t'kosha* fal, *rrnosh, shkosha*. Fenomeni nuk është karakteristik për Mirditën: *mefshim, mifshi*, si edhe për të folmet e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës: *ndiefsha*²⁷.

4. Forma me *-et* e rrjedhore së emrave të gjinisë femërore në funksionin e një plotësi të cilësisë, të shfarësisë e të lëndës: *mish lopet, buk theknet*.

Këtë formë rasore e gjejmë në Theth: *rreth ciçarjet, seter tkuret*,

25) Materialet e sjella për Zadrimën janë mbledhur në Pistull nga V. Lohja. Për këto materiale nuk do të japim referime.

26) Materialet për të folmen e Pukës janë nxjerrë nga punimi i pabotuar i Xh. Topallit, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*.

27) J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSHT, SSHSH, 1963, 4, f. 179.

brushe rrojet, qiri dritet, strajc buket; në Shkrel: kufi toket, mish delmet, mish lopet, gem dardhet, ven rneset, gra Shalet; në Kastrat: tamël lopet, mish breshket, rub krejet, krym toket, buk theknet, roje fushet (Gj.Sh. S.F., 1967, 2, f. 47); në Lohe të Sipërme: opâk lopet, ulisht bletet, mish roset, mish fllâxet; në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit, të cilët janë të ardhur nga Malësia e Madhe: krah punet, tok buket (Gj. Sh. Lissus, f. 162); në Dushman: lopet, vashet, fmijet, brijet (W.C. v.c. f. 58, 59, 61 etj.); në Shkodër: mish lopet, mish dhijet, mish pulet; në Shirokë: elkur lopet, lesh dhijet, tok buket, qoshe lundret (T.O. v.c. 1966, f. 247). Fenomeni është i përhapur edhe në Nikaj-Mërtur: lesh delmjet, var pushket, qoshe shpijet (E.L. v.c. f. 121). Kjo trajtë e rrjedhores në të folmen e Mirditës, me përjashtim të ekstremit veriperëndimor (Laç, Blinisht) ku është mjaft e përhapur, ndeshet në mënyrë sporadike. Ajo është përgjithësuar edhe në Pukë. Ajo mungon në Tropojë (J.Gj. BUSHT SSHSH, 1963, 4).

Si duhen vlerësuar tiparet e tjera të parashtruara si veçori dalluese të këtij grupi të folmesh?

1. Pohimi se grupi i zanoreve *oe* në grupin perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes ka dhënë *ö* (*œ*)²⁸ nuk vërtetohet plotësisht nga të dhënat e reja të grumbulluara gjatë gjurmimit të të folmeve të këtij grupi.

Për të folmet perëndimore të nëndialektit verior të gegërishtes, siç rezulton nga materialet e grumbulluara, është karakteristik rezultati i dyfishtë i zhvillimit të grupeve të zanoreve *oe* në *e* dhe *ö*.

Varianti *e* i *oe*-së është i përhapur në pjesën veriore të territorit të këtyre të folmeve: në Shkrel: *ve, ves, vini re*; në Kastrat: *ves, ve, pul vese; ven re* (Gj. Sh. SF, 1967, 2, f. 44), në Lohe të Sipërme: *ves, ve, veni re*; në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit që janë të ardhur nga Malësia e Madhe: *ve, pul vese, ves-a, veni re* (Gj. Sh. Lissus, f. 161).

Varianti *ö* i *oe*-së është i përhapur në pjesën jugore të territorit të këtyre të folmeve: në elementin mysliman të Kastratit: *vö, vöse* (Gj.SH. SF, 1962, 2, f. 44); në Dushman: *vö, rö* (W.C. v.c. f. 7); në Shkodër: *vö, rö, vös*; në Shirokë: *vö, vös* (transkribuar nga autori i punimit *vö, vös*) (T.O. v.c. 1965, f. 379) dhe pjesërisht edhe në Zadrimë: ven *orö*. Atje ndihen edhe varianti *oe* e *e* *voe, ves*. Në të folmen e Nikaj-Mërturit grupi i zanoreve *oe* ruhet si i tillë: ni *voe*, shum *voe*, u zien *voet*, kemi *droe* (E.L. v.c. f. 113). Në të folmen e Pukës grupi i zanoreve *œ* > *oe*, *oe* e *o*. *O*-ja ndeshet më shpesh. Në të folmen e Mirditës ky grup zanoresh zakonisht nuk kontrahohet *voe*, ven *roe*. Në raste të veçanta e me subjekte të veçuar vihet re edhe tendenca e reduktimit në *o*: *vot* (Kaçinar, Grykë, Orosh), ven *oro* (Thirrë), *voja* (Psek).

2) Nga të dhënat e reja të grumbulluara gjatë gjurmimit të të folmeve të këtij grupi del jo i përcaktuar pohimi «që veç Shkodrës ku *ue, ye, ie* janë monoftonguar në shumë të folme (të këtij grupi B.B.) gjejmë sot togje zanoresh *ue, ye, ie*, sidomos më shumë në rrokje fundore të hapët» dhe jo i pranueshëm vlerësimi i kësaj gjendjeje si një tipar dallues i këtij grupi të folmesh.²⁹

28) N. Jokl, *Linguistisch — Kulturhistorische...* f. 207; E. Çabej, *Diftongje...* f. 82; J. Gjinari, *Dialektologjia...* f. 77; *Sprovë...* f. 112; *Kursi i dialektologjisë...* f. 72-73; E. Lafe, *E folmja...* f. 136.

29) J. Gjinari, *Dialektologjia...* f. 77:

Cila është në të vërtetë gjendja reale e këtyre grupeve të zanoreve në të folmet e grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes edhe ruajtja e këtyre grupeve a përbën një veçori dalluese të këtij grupi të folmesh?

Gjendja paraqitet si vijon: në Theth grupet e zanoreve *ue, ye, ie*, ruhen: *grue, krue, due, thue, luej, kërkuen, puntuer, truell, fyell, dyer, diell, qiell, miell, ziej, niej* (J.K. v.c. f. 256); në Shkrel, krahas togjeve të zanoreve *uo, ua, ue, uë*, u dëgjua edhe varianti i reduktuar i tyre *u*. Në fshatin Stol të Shkrelit në fund të fjalës u dëgjuan kryesisht variantet *ua, u*, kurse në trup të fjalës kryesisht variantet *ue, u*. Edhe në dy pikat e tjera të Shkrelit të vrojtuar (Dedaj, Vrith) mbizotëron përdorimi i togut të zanoreve *ua* në fund të fjalës dhe i togut *ue* në trup të fjalës. Në Vrith një përqindje të mirë zë edhe përdorimi i *uo*-së, të cilën e ndeshëm me një denduri të barabartë përdorimi dhe në fund edhe në mes të fjalës.

Edhe grupet e zanoreve *ye, ie* në Shkrel dëgjohen herë të plota e herë të reduktuara respektivisht në *y, i*. Në Kastrat në mes të fjalës ka *uo: mzuor, kjuor, unuor, shuoll, grruoll, pluor, muoj* etj. Në brezin e vjetër në ndonjë rast *uo*-ja ndeshet edhe në rrokje të hapur: *duo, prruo, thuo*. Togu *ua* gjendet vetëm në rrokje fundore të hapur: me *punua*, me *shkua*, me *u gzuu*, me *gjua, krua, prrua, grua* etj. Grupi i zanoreve *ye* ruhet kryesisht në rrokje të hapur: *krye*, me *çkye*, me *thye*, me *lye*. Ndeshet *ye*-ja edhe në pozicion në mes të fjalës në rrokje të mbyllur: *fyell, kaptjell, gjypnyer, fnyer, kapërcyell* etj.. Ruhet gjithashtu edhe grupi i zanoreve *ie: diell, qiell, miell, kthiell, bërziem* (Gj.Sh. S.F., 1967; 2, f. 40). Në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit grupi i zanoreve *uo* gjendet kryesisht në mes të fjalës, ndërsa togu *ua* gjendet vetëm në rrokje fundore të hapët: i *shtërguot, buoloj, gruo, shkuome, msuos*, me *dimnua*, me *jetua*, me *knua*, me *rrethua* etj. Ruhen gjithashtu edhe grupet e zanoreve *ye, ie: me thye*, me *lye, krye, fyell, kapërcyell, kërcyell, diell, miell* etj. (Gj.Sh. Lissus, f. 158). Edhe në Lohe të Sipërme janë dëgjuar variantet me tog zanor *ua, ue, u^e/ye, y^e/ie* dhe variantet me zanore të thjeshta *u, y*. Të parat janë mbizotëruese: ka *pushua*, me *ñrrua*, ke *punua*, kanë *shkue*, kanë *lejue*, ka *flue*; *grue^e ja, shkuen, duelm, fillu^em; shkune, punum, u martume*; kemi *thye*, me *çkye, thyn, tu fry, dielli, e bërzie*. Në Dushman gjithashtu ruhen grupet e zanoreve *ue, ye, ie: mue, krue, thue, dyell, me lye, me thye, diell, miell, me zie* (W.C. v.c. f. 10).

Në Shkodër grupet e zanoreve *ue, ye, ie* janë reduktuar respektivisht në *u, y, i*. Edhe në të folmen e Shirokës këto grupe paraqiten të reduktuara në zanoret e thjeshta, *u, y, i: puntur, malcur fyll, dyll, me ly, me shky, kry dill, qill, mill* (T.O. v.c. 1966. 5, f. 380). Në Zadrinë gjithashtu këto grupe zanoresh sot na paraqiten të reduktuar respektivisht në *u, y, i: t'plagu, patku, thu, gru, penu rrethu, me kalu, me punu, pushkatu, qñru, bull, narkume, laknur: dyr, thyn, shyt, kry, qill, dill*.

Nga kjo pasqyrë e shpejtë e gjendjes së këtyre grupeve të zanoreve në këto të folme bëhet e qartë që grupi perëndimor i nëndialektit verior të gegërishtes ndahet në dy nëngrupe: në një nëngrup verior që i ruan në pjesën më të madhe këto grupe zanoresh të pamonoftonguara dhe në një nëngrup jugor që i monoftongon ato respektivisht në *u, y, i*, pa përjashtuar në raste të veçanta mundësinë e gjetjes këtu të grupeve të zanoreve *ue, ye, ie*. Në këto rrethana mendojmë se nuk mund të mirret

si një tipar dallues i grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes ruajtja e grupeve të zanoreve *ue, ye, ie*.

Këto grupe zanorësh ruhen edhe në të folmen e Nikaj-Mërturit (E.L. v.c. f. 113) në të folmet e rrethit të Tropojës (J.Gj. BUSHT, SSHSH, 1963, 4, f. 177. Në të folmen e pjesës veriore të Pukës (Iballë) grupet e zanoreve *ue, ye, ie* ruhen më mirë se në pjesën jugperëndimore (Qelzë, Qerret, Kabash e Pukë). Në të folmen e Mirditës gjithashtu bashkekzistojnë variantet *ue, ye, ie* dhe variantet *u, y, i* të tyre.

3. Të dhënat e grumbulluara nuk mbështesin edhe pohimin se grupi i bashkëtingëlloreve *fsh > sh* në këtë grup të folmesh³⁰. Sikurse u provua edhe më sipër kjo qëndron për *fsh*-në e mënyrës dëshirore të foljeve me temë në zanore, kurse nuk qëndron për *fsh* tjera. Ky grup bashkëtingëlloresh në fillim e në mes të fjalës ka përfunduar në *ps*h në pjesën veriore të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes: në Shkrel: *ps*his, *ps*sheh, *ps*htjell, *ps*hik, *kap*shat, *rrap*sh, me *rrap*shit; në Kastrat: *ps*hik, *kap*shat, *rrap*sh, *rrap*shojë (është takuar, por rrallë edhe *shik, kashat*) (Gj. Sh. SF 1967, 2, f. 43); në Lohe të Sipërme: *ps*his, e *ps*htollme por *ms*hehena; kurse në pjesën jugore në *ms*h, *sh*: në Shkodër *ms*sheh, *ms*htjell, *sh*is, *sh*ij, *sh*ik, *kashat*; në Shirokë: *kashat, kosha, mndash, shijë* (T.O. 1965, f. 382); në Zadrimë: *ms*hij, *ms*sheh.

4. Për t'u parë është edhe pohimi se në grupin perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng* asimilohen respektivisht në bashkëtingëlloret disi të zhurmshme: *m̄, n̄, ŋ*³¹.

Nga materialet e mbledhura rezulton se për këtë grup të folmesh është karakteristik zhvillimi i grupit të bashkëtingëlloreve *mb* në dy drejtime, në *m* dhe në *b* (*p*). Varianti *m* i *mb*-së është i përhapur në gjithë territorin e këtyre të folmeve: në Theth: *mr*am, *mr*apa, *mat math, met* (J.K. v.c. f. 258); në Shkrel kalimi i *mb > m* është shumë i përhapur: *mesa mren, mrapa, musha, ja merrim, me mleth, me majt*; në Kastrat: *kam met, kam mllell, kâmt, shkami, e myllme* (Gj. Sh. SF. 1967, 2, f. 42); në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit, që janë të ardhur nga Malsia e Madhe: *llâmt, mytet pllûm, kama* (Gj. Sh. Lissus, f. 160); në Lohe të Sipërme: *dhâmt, llomall, mlolle, mren, grumull*; ja *mrrim, mlee* «mbuloje»; në Dushman: me *majt, me myll, me msheh, me mledh, dham* (W.C. v.c. f. 26); në Shirokë. *mas, myll, mrend, mi, miû, marim, kam, dhami, plumi* (T.O. 1965, f. 382); në Zadrimë: *kumullave, grumull, millshin, shkam*.

Në të folmen e Nikaj-Mërturit ky grup bashkëtingëlloresh ruhet në pozicion nistor e në pozicion në trup të fjalës, kurse në pozicion fundor elementi i dytë dëgjohet zakonisht i rëgjuar ose ndonjëherë s'dëgjohet fare: e *mbajke, mbas, mbath, mberzia, mbesa, mbet, mbjell, mblojë, mbra-pa, mbrenda, bumburon, dumbdhet, kollombog, permbas, permbi, shkëmbëz, thumba; m'dhem^b, dhimb, plamb shkamb^b* (E.L. v.c. f. 115).

Në të folmen e Pukës dhe në të folmen e Mirditës *mb > m*

Varianti *p* i *mb* ndeshet në ndonjë rast edhe në Theth: *projtja* «mbrojtja» (J.K. v.c. f. 255). Dëshirojmë të shënojmë që në Theth nuk kemi ndeshur ndonjë rast tjetër me *p* të ardhur nga *mb*, ndonëse vrojtimit të veçanta nuk janë bërë për këtë problem.

30) J. Gjinari, *Dialektologjia...* f. 77; *Sprovë...* f. 112; *Kursi i dialektologjisë...* f. 73; E. Lafe, *E folmja...* f. 136.

31) J. Gjinari, *Dialektologjia...* f. 77; *Sprovë...* f. 112; *Kursi i dialektologjisë...* f. 73.

Edhe në Shkrel fenomeni paraqitet i kufizuar: në Shkrel: *âhâ°pi* (*llâopi*), *m'dhêp* (*llêp*) me ja *prri*, me *projt*, pe *bloj*, *pen* «mbetmë»; në Kastrat raporti, është i barabartë me *m*: pa *bliedh*, *blodhën*, me *bloj t'keqe*, me *bush*, më *pramja*, kan *pêt*, *pi* shpi «mbi» shpi, pe *pyt* «mbyt», *llaâpi* «dhëmbi», nuk mun *pahesh* «mbahesh» (Gj. Sh. SF 1967, 2, f. 42); në të folmen e Malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit: paj «mbaj», *n'prâmet*, *pi* «mbi» shpi, u *pytsh* «u mbytsh» s'mun të *bâj* «mbaj» (Gj. Sh. Lissus, f. 160); në Lohe të Sipërme: *m'dhêp* kryet. Në materialet tona të mbledhura në Lohe të Sipërme nuk gjetëm ndonjë rast tjetër të kalimit të *mb* me *b* (*p*), ndonëse vrojtme të veçanta nuk janë bërë për këtë problem. Reduktimi i grupit të bashkëtingëlloreve *mb* në *b* (*p*) mungon në Dushman (W.C. v.c.), në Shkodër, Shirokë (T.O. 1965, f. 382) e Zadrimë.

Grupi i bashkëtingëlloreve *nd* ka pësuar në të folmet e grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes një zhvillim të trefishtë, në *n*, *ñ*, *d* (*t*). *nd* > *n* në Theth: *Nue*, *nesh*, «ndesh», *nêjun* «ndejun», *n'jesha* «ndjefsha», *nezi*, «ndezi», *kanar* «kandar», *mâna*, «manda», *manej* «mandej», *men* «mend» (J.K. v.c. f. 257); në Shkrel: me *nej*, e *nýt*, *nalu*, me *rrrua*, *nêrshej*, *men*, *ven*, *gjin*, *katërqin*, *gan*, *hun*, *parmen*, *ynyr*, *knejna*, *anej*, *anejna*, *shnosh*; në Kastrat: kam *nej*, *menen*, *gjinen*, *hûna*, jan *munua*, *kuvëni*, *nrejt*, *neri* (Gj. Sh. SF, 1967, 2, f. 42); në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit: *vên*, *katûni*, *men*, *naluome*, *shkun*, *parmen*, *lunër*, *knon* (Gj. Sh. Lissus, f. 160); në Lohe të sipërme: *mren*, *nig-jova*, *n-jeva*, *i patunun*, *kunreshitim*, e *nershime*, *nal*, *nim*, *ven*, *mun* ta zan. *n-jek*, ka *shnerue*, e *râ°n*, *knejna*, *knon*, *fun hûn*, *katon*, *shnosh*, *hanak*, *haniqe*; në Dushman: me *nalue*, me *nimue*, me *n-jek*, me *n-jell*, me *nez*, *noj*, *huna*, *kallnuer*, *kshnella*, *nrejt*, *anej*, *knej* (W.C. v.c. f. 25); në një numër të kufizuar fjalësh edhe në Shirokë: me *nej*, *nal* (T.O. 1965, f. 382).

nd > *ñ* në një numër të kufizuar fjalësh në Lohe të Sipërme: *ñreq'*, *ñershoj*, *ñryshk*, ke *ñrrua*, *ñryshe*; me dy fjalë të vetme në Dushman: *tañe*, me *ñie* (W.C. v.c. f. 25). Ne besojmë që këtë variant të *nd* ka pasur parasysh T. Osmani, kur pohon se «në të folmen e Shirokës ne vërejmë se ky grup në shumicën e rasteve nuk asimilohet në *n*. Në pozicion nistor grupi *nd* dëgjohet i plotë: *ndig-joj*, *Ndoc*, *vend*, *mendoj*, *gjind*, *ndry*» (T.O. 1965, f. 382). *nd* > *ñ* gjithashtu në Shkodër e në Zadrimë: *mañ* e *rañ*, *dhañërr*, *ñig-joj*, *rañsi*, *ñy*, *ñryshe*, *uñyr*, *qeñru*, *ñer*, *ñal*. Fenomeni mungon në Nikaj-Mertur dhe në Mirditë (me përjashtim të Laçit të Mirditës në ekstremin veriperëndimor të saj, ku gjenden raste të këtij evolucioni).

nd > *d* (*t*) në Shkrel në një numër të kufizuar rastesh: djalin *tâôt*, *trysh* «ndrysh», *tejn* «ndejn», *â° tesh* «ndesh», *â°dërr*, *medërr* «mendërr», *ven i dejun* «i ndejun»; në një numër të vogël fjalësh edhe në Kastrat: *mêderr*, *dërgishte* «ndergishte», *dërzehen* «ndërzehen», *âdrra* «andrra», me *dry* «ndry», *dersy* «ndersy», *dershej* «ndershej», *dermjet* «ndermjet», *mett* e mija «mendet», *tryshe*, *vêtit* s'luote «vendit», jan *permet*, prej *têjet* «ndejet», *tiej* «ndiej», kam *tesh*, ka *kuvet* «kuvend», *hâta*, *Kelmëti*: ka *toll* «ndodh». Raporti në mes të *n*-së e *d*-së dhe *t*-së që vinë nga *nd* është 5/3/1. Variantet *d*, *t* të *nd*-së ndeshen gjithashtu në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit, sidomos te brezi i vjetër: *âderr*, *kûder*, *hûder*, *thûder*, *tiej*, *tejun*, *Kelmet*, *vet*, *mêt*, n'mi ka *âta* (Gj.Sh. Lissus, f. 160). Kalimi i *nd* në *d* (*t*)

nuk ndeshet në Lohe të Sipërme, në Shkodër, në Shirokë, në Zadrimë e në Mirditë.

Grupi i bashkëtingëlloreve *ng* në të folmet perëndimore të nëndialektit verior të gegërishtes ka pësuar një zhvillim të dyfishtë, ai ka kaluar në *η* dhe *g(k)*.

ng > *η* në Theth: *kunuj*, *çeqel*, *ciçare*, *haqerta* dreqi, *çuη*, me *qatrrue*: në Shkrel: *jan qatrrua*, pa *ηg*, me *ηa*, me *ηul*, *qarkoj*, *haqer*, *cuηela*, *çηul*, me *meηue*, *maηut*, *ciçare*, *kūηull*, *la^oη*, *huηron*, *kūηullaç*, me *shter^oua*, *de^oη*; në Kastrat: *thi^oηill*, *cuηel*, *ηul*, me *haqer*, *l^oη*, *ka^oη*, *qarkes* (Gj. Sh. SF, 1967, 4, f. 43); në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit: *shtru^oη*, *ka ηa*, *qrehin*, *ka^oη* (Gj. Sh. Lissus, f. 160); në Lohe të Sipërme: *çarkoj*, *shll^oη*, *kūηull*, *opā^oη*, tu *qreh*, i *qulun*, pe *ηuli*, i *ç^oā^ot^oηt*, *qarkoj*, *cuηel*. Në Dushman *ng* > *g*, që, simbas tij, duhet trajtuar si një artikullim i vetëm dhe jo si një grup i zakonshëm bashkëtingëlloresh *ηg* ose si geminante *ηg*; kjo, simbas tij, përfaqëson diçka të ndërmjetme në mes të njëres dhe të tjetrës: me *ηga*, me *ηsul*, me u *ηsop*, me u *ηsi*, me u *ηsordh*, me *ηsarkue*, i *ηsusht* (W.C. v.c. f. 23-24). Fenomeni i kalimit të *ng* > *η* është përgjithësuar edhe në të folmen e Shkodrës. Këtë variant ka pasur parasysht T. Osmani, siç na ka kumtuar ai, kur shkruan: «grupi *ng* nuk është asimiluar, ai dëgjohet i plotë, por që spikat ma tepër tingulli i dytë: *ngas*, *ngi*, *ngul*, *kangs*» (T.O. 1965, f. 382).

Varianti *η* i *ng*-së është përgjithësuar edhe në Zadrimë: *ηul*, *ηa*, *ηi*, *qatrru*, *qre*, *qroh*, *qarkue*, *qri*, *haqer*, *l^oη*; *kūηull*, *opā^oη*, *shll^oη*, *la^oη*, *de^oη*, *ma^oη*.

Varianti *n* i *ng* mungon në Nikaj-Mërtur, atje dëgjohet *ng*, kurse është i përhapur në pjesën veriperëndimore e jugore të Mirditës (Laç, Kaçinar, Blinish, Munaz, Fang, Kodër Rrëshen).

ng > *g* (k) në Shkrel: *jam gi* (ngina), tu *grān*, *gushllek*, *grina*, me *gatrru*, kem *gul*, *ciçare*, me *hāqer*, *magut*; *shtërgica*, *magulon*, *krihet* «ngrihet», *jan katrrua*; në Kastrat: kam *hāqer*, ka *greh*, *kugūll*, mos u *gut*, *mūgon*, me *shtërgua*, *ciçel*, *gihem*, *cigla*, *lgote*, me *kre^oη* «ngreh», *katrrusa*, *kulini*, *apā^ok* (Gj. Sh. SF, 1967, 2, f. 43); në Lohe të Sipërme: ka *gē*, *hogre*, me *gatrrua*, me *gūl*, *mugon*, *magūt*, me *shtërgua*, *shllūg*, *ciçare*, me *ga*, *cuçel*; *krihet*, *opōk*, *mōkt*. Fenomeni i kalimit të *ng* në *g* (k) mungon në Dushman, Shkodër, Shirokë e Zadrimë.

Nga këto që u thanë rezulton se në të folmet e grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng* kanë pësuar zhvillime të dyfishta e të trefishta. Në të gjitha të folmet e këtij grupi vihen re këto zhvillime: *mb* në *m* dhe *ng* në *η*. Në të folmet veriore të këtij grupi, krahas këtyre evolucioneve, vihen re edhe evolucionet *mb* > *b* (p), *nd* > *n*, *nd* > *d* (t), *ng* > *g* (k), kurse në të folmet jugore edhe *nd* > *n̄*. Në këto rrethana bëhet e qartë se nuk është as e plotë as e saktë thënja që grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng* asimilohen respektivisht në *m̄*, *n̄*, *η*, në të folmet e grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes.

Duhet pranuar si një evolucion karakteristik për të folmet e këtij grupi kalimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *ng* respektivisht me *m*, *η* të thjeshta në një kategori të caktuar të fjalëve që në gjuhën letrare dalin me *mb*, *ng*, kurse për grupin *nd* puna qëndron mjaft ndryshe nga sa është pohuar. Ajo që është karakteristike për të folmet e nëngrupit jugor të grupit perëndimor është përgjithësuar për gjithë grupin perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes.

Do të ishim të paplotë po qe se do të mjaftoheshim me këto. Të folmet e grupit perëndimor kanë edhe të tjera veçori dalluese që nuk janë evidencuar deri më sot ose që janë shikuar si karakteristike për nëndialektin verior po që nuk janë të tilla. Këto janë:

1. Kalimi i një *a*-je gojore të theksuar zakonisht në rrokje të mbyllur pranë bashkëtingëlloresh qiellzore-dhëmbore ose qiellzore në një *ç* të hapur, në një numër të kufizuar fjalësh (shih edhe A. Dodi, S.F. 1967, 3, f. 140). Fenomeni takohet në Shkrel: *tësh, nëlt, prep, me dësht, mjëft, zjerm, i g-jet, çuqel, mere, ejet, ejka, nëraher*. Por u dëgjuan edhe format me *a*, sidomos në pjesën veriore të Shkrelit në Vrith: *tash, zjarmin, prap, larg*.

Ndonëse rrallë edhe në disa subjekte fenomeni ndeshet edhe në Kastrat: *nält, këq, mjäft* (Gj.Sh. SF, 1967, 2, f. 38-39). Simbas një kumtimi me gojë nga autori i këtij punimi, me *ç* dhe jo me *a* dalin edhe fjalët *prep, zjerm, dynjë, ejet, ejka, mëre*. Fenomeni, me sa duket, mungon në Dushman: prej *s'largut*, prej *s'naltit*, per *s'glatit* (W.C. v.c., f. 105); është tepër i kufizuar në Lohe të Sipërme: *mjëft, ejet, ejka*, por *nalt, tashti, jetash, prap, zjarm*.

Në Shirokë fenomeni është i përhapur në fjalët: *lërk, prep, tësh, n'pik t'vrëpit, t'lërktit* (T.O. 1965, f. 379); në Shkodër (ndonëse edhe këtu vihen re lëkundje) në fjalë si *tësh, prep, zjem, nëlt, mjëft, lërg*. Fenomeni mungon në të folmen e Nikaj-Mërturit, atje dëgjohen *prap, tash* (E.L. v.c. f. 131). Në Pukë bashkekzistojnë format me *a* dhe ato me *ç*. Këto të fundit janë mbizotërueset. Edhe në Theth kemi dëgjuar: *zjarm, larg, tash* por edhe *lërg*. Fenomeni mungon edhe në Mirditë me përjashtim të ekstremitet veriperëndimor (Laç) ku fenomenin e kemi ndeshur në një rast të vetëm.

2. Asimilimi i grupit të bashkëtingëlloreve *ngj* në *nj* në një kategori të caktuar fjalësh. Ky fenomen ndeshet në Theth: *Shnjergjit, njuhët*; në Shkrel: *zenjinlek, njala, njat, thenjill, jau njiti, shnjon, shnjergj*, me *njesh*; në Kastrat: *njal, Shnjergj, njat, njesh* (Gj.Sh. SF 1967, 2, f. 43); në Lohe të Sipërme: *njyey, njala, u njall, në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit: njalat, t'u njat, t'njelm* (G.Sh. Lissus, f. 161); në Dushman: *njala, njati, njesh, njesh, me njesh, me njit, njat* (W.C. v.c. f. 24); në Shkodër: *njala, njit, njesh, Shnjergj, njesh, zenjin, njy, u njall*; në Shirokë: *njal, njesh, njit* (T.O. 1965, f. 382); në Zadrimë: *njal, me u njit, me u njall, me njy, franji, zenjin, Shnjergj*.

Fenomeni mungon në Nikaj-Mërtur; atje ky grup bashkëtingëlloresh ruhet në të gjitha pozitat (E.L. v.c. f. 116). Në Pukë grupi i bashkëtingëlloreve *ngj > x* (bashkëtingëllore prepalatale e afrikuar).

Në Mirditë ky grup bashkëtingëlloresh ka përfunduar në *gj'* ose në *xh* në gjithë rastet. Vetëm fjala *njat* (<ngjat) në disa pika veriore të Mirditës dëgjohej me *nj*.

Duhet shënuar se në disa nga të folmet e grupit perëndimor ndeshen edhe variantet *gj, j, q, n, g, n* të *ngj*.

Në Shkrel ndeshen variantet: *j, gj, q, n : ejell, jal, zejën, qigjin, ja kin gjit, rregjë, qiqi, me qye; thñih, franjh, frenit*, në Kastrat: *gj, q, n : u gjall, zëgjinat, gjietit; me qye, me ja qit, qiq, me ja nit; me njesh, njeti* (Gj. Sh. SF, 1967, 2, f. 43); në Lohe të Sipërme: *g - j, j, gj, n, n : përg-jet, g-jasin, ejëll; qigjin; franji; me nit, Shnjergj*; në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit varianti *gj : ùgjillit, t'gjelme, gjietit* (Gj. Sh. Lissus, f. 161) në të

folmen e Shkodrës, Shirokës e Zadrimës varianti j në fjalën *kij* «qingj».

3. Mbaresa *-me* e vetës së parë shumë të së kryerës së thjeshtë të të gjitha foljeve veprorë. Kjo ndeshet në Shkrel: (na) *punuëme, bame, pame, shkume, bashkume, thyeme, rame*, por edhe *ram, pam, thym*; në Kastrat: *shkuome, bërtitme, prùme, bame; thame, pame, dame, rame*, të rruome (Gj. Sh. SF, 1967, 2, f. 54); me të folmen e Lohes së Sipërme: *punueme, mollme, sollme, bame, bajtme, kositme, mihme, shtrume, pjekme*; në të folmen e Dushmanit bashkekzistojnë mbaresat *me dhe ëm (m)*: *mlodhme, hodhme, hoqme, suellme, matme, shitme, rrsheitme, pjasme, lame, pime, punueme, lyeme*, por *muerm, ujdisëm, tretëm, rritëm, vram, ziem, ruejtëm* (W.C. v.c., f. 125-152): në Shkodër ndeshet mbaresa *-me*: (na) *punume, dulme, fitume, qitme, hime*; edhe në të folmen e Shirokës ndeshet vetëm mbaresa *-me*: *morme, xorme, punume, shkume, xume, narkume, çilme, dolme, pime, ngarkume*.

Për të folmen e Zadrimës na mungojnë materialet.

Në të folmen e Nikaj-Mërturit kësaj mbarese i përgjigjet mbaresa *ëm (m)* në gjitha rastet: (na) *dhezëm, muelëm, mbuellëm, pshtuellëm, prashitëm, pritëm, frym, fjetëm, getëm, kerkuëm, shkuëm, dam, lam, shkruem* (E.L. v.c. f. 127). Edhe në Mirditë në vetën e parë shumë të së kryerës së thjeshtë mungon mbaresa *-me*, asaj i përgjigjet mbaresa *-ëm (m)*: *kam, punum, flem, peëm, perzim, dulëm, shprazëm, prefëm, volëm, molëm* etj.

4. Ekzistenca vetëm e mbaresës *-h-ena (h-na)* për formimin e vetës së parë shumë të së tashmes së dëftorës të foljeve të diatezës pësore.

Kjo mbaresë është e përhapur në Shkrel: *mlidhena, llafosena, nisena, zehena; rrxohna, lshohna, bashkohna*; në Kastrat: *munohena, bâhena, gzohena, luvdohena, çohena, mërzitena, çuditena, gjinena, bashkohena* (Gj. Sh. SF, 1967, 2, f. 57); në të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit: *bahena, munohena, gzo-hena, luvdohena, merzitena, thrritena*, (Gj. Sh. Lissus. f. 168); në Lohe të Sipërme: *rrxohena, martohena, çohena, lohena, qieshena*; në Dushman mbaresa *ena* është mbizotëruese; nga shtatëmbëdhjetë shembuj që gjenden te Cimohovski 16 dalin me mbaresën *-ena* dhe vetëm një me mbaresën *-emi*: *teshena, mlidhena, hidhena, siellena, tretena, rritena; lahena, kru-hena, lyhena, thehena, bahena, zihena, munena, thohena, shifena, nepena* (W.C. v.c. f. 128, 130, 132, 135, 139, 141, 145, 150, 152, 153, 154, 185, 188, 191, 192, 193) por dirzemi (W.C. v.c. f. 33); në Shkodër: *lodhna, çohna, tahna, shifna* etj. në Shirokë: *lahna, kthehna, nisna, çohna, merrna prishna. lodhna, mytna* (T.O. 1966, f. 252); në Zadrimë: *ñrehna, pergjegjna, tallna, lodhna, qeshna, luvdohna, lahena, ñrohena, largohena, rrxohena, ritena*.

Në Nikaj-Mërtur veta e parë shumë të së tashmes së foljeve të diatezës pësore formohet me anë të mbaresave *-(h)em(i)* dhe *-(e)na*, nga të cilat e para përdoret më shpesh: (na) *avytem, gzohe, lahem, shtrihem, dergem, ngitem; pjakemi, çohemi* etj. si edhe *merrna, lahena, puqena, rrezitena, shtrengohena* etj. (E.L. v.e. f. 129).

Në të folmen e rrethit të Tropojës është përgjithësuar mbaresa *-(h)em* (J. Gj. BUSHT SSHSH, 1963, 4, f. 185).

Në të folmen e Pukës është përgjithësuar mbaresa *-(h)na*.

Në pjesën veriore, perëndimore e jugperëndimore të Mirditës (Laç, Kaçinar, Kodërspaç, Blinisht, Thirre, Munaz, Fang) foljet e formës pësore marrin në vetën e parë shumë të së tashmes së dëftorës mbaresën *-(h)na*; në Grykë Orosh dëgjohen si format me mbaresën *-na* ashtu edhe ato me mbaresën *(h)emi*. Në pjesën jugore dhe lindore të Mirditës

(Kodër-Rrëshen, Prosek, Zajs) ndeshet vetëm mbaresa (*h*)emí.

Nga gjithë sa u tha gjer tani, rezulton se veçoritë dalluese të të folmeve të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes në fushën e fonetikës e të morfologjisë janë më të shumta se ato që janë pranuar gjer tani. Përveç kësaj veçoritë dalluese të sjella më sipër për grupin perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes nuk kanë të njëjtën vlerë.

1. Ka vlerë absolute për veçimin e këtij grupi të folmesh nga gjithë grupet e tjera të të folmeve të nëndialekteve të gegërishtes kalimi *kl*, *gl* respektivisht në *k-j*, *g-j*: *kjumsht*, *g-juh*.

2. Kanë vlerë absolute për veçimin e këtij grupi të folmesh nga grupet e tjera të të folmeve të nëndialekteve të gegërishtes dhe relative për veçimin nga grupi lindor i nëndialektit verior të gegërishtes këto: a) kalimi i një *a*-je gojore të theksuar, zakonisht në rrokje të mbyllur, pranë bashkëtingëlloresh qiellzore-dhëmbore ose qiellzore me një *ç* të hapur në një numër të kufizuar fjalësh: *tësh*, *prep*; b) reduktimi i grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* në *sh* në mënyrën dëshirore të foljeve me tamë në zanore: *rrnosh*, *kjosh*; c) formimi me mbaresën *-et* i rrjedhore në njëje të emrave të gjinisë femërore në funksionin e një plotësi të cilësisë, të shfarësisë e të lëndës: mish *lopet*, buk *theknet*; ç) formimi me mbaresën *-me* i vetës së parë shumë të së kryerës së thjeshtë të të gjitha foljeve: na *bame*, *pame*.

3. Kanë vlerë relative për veçimin e këtij grupi të folmesh nga grupet e tjera të nëndialekteve të gegërishtes dhe absolute për veçimin nga grupi lindor i nëndialektit verior të gegërishtes:

a) asimilimi i grupit të bashkëtingëlloreve *ngj* në *nj* në një kategori të caktuar fjalësh që në gjuhën letrare dalin me *ngj*: *njala*, *njesh*; b) formimi i trajtës aspektive të së tashmes me anë të foljes *jam* dhe përcjellores së foljes kryesore: *jam tu ja çu* mikut. Kjo në të folmet e grupit lindor të nëndialektit verior, sipas J. Gjinarit, realizohet me anë të foljes *jam*, pjesëzës *ka* dhe të së tashmes së foljes që mban kuptimin kryesor (*jam ka punoj*) (J.Gj. SF, 1966, 4, f. 113). Duhet shënuar se kjo nuk është trajtë e vetme aspektive e së tashmes në këtë grup të folmesh.

4) Kanë vlerë relative për veçimin e këtij grupi të folmesh nga grupet e tjera të të folmeve të nëndialekteve të gegërishtes (duke përfshirë këtu edhe grupin lindor të nëndialektit verior të gegërishtes): a) reduktimi i grupit të zanoreve *ae* me *e*: (ti) *pe*, *thë*; b) reduktimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *ng* respektivisht me *m*, *η* në një kategori të caktuar fjalësh që në gjuhën letrare dalin me *mb*, *ng*: (une) *mush*, *ηarkoj*; c) formimi i vetës së parë shumë të së tashmes së dëftores së foljeve të diatezës pësore me anë të mbaresës *-h-ena* (*h-na*): (na) *mlidhena*, *lshohna*.

5. Ka vlerë relative për veçimin e këtij grupi të folmesh nga grupi lindor i nëndialektit verior të gegërishtes formimi i trajtës së shquar të emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me *k*, *g* me anë të mbaresës *-u*: *ujku*, *zogu*, gjë që në të folmet e grupit lindor, sipas J. Gjinarit, realizohet me anë të *-i* (J.Gj. SF, 1966, 4, f. 113).

III. Tashti që kemi përcaktuar tiparet më themelore dalluese të të folmeve të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes bëhet e mundur të jepet një mendim më i argumentuar edhe mbi shtrirjen territoriale të këtij grupi të folmesh.

Dy janë të folmet për të cilat, sikundër u tha edhe më sipër, mun-

gon një pikëpamje unike lidhur me përfshirjen ose jo të tyre në grupin perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes. Këto janë e folmja e Mirditës dhe e folmja e krahinës së Pukës.

Për të folmen e Mirditës janë mbrojtur dy pikëpamje të ndryshme. M. Lamberci në një punim të parë të tij e afronte të folmen e Mirditës me të folmen e Lurës, Kthellës dhe Matit.³² Në një punim të dytë të tij, ndryshe nga ato që shkruante më 1916, e afronte të folmen e Mirditës me të folmet e grupit perëndimor (ai i quan «gegërishte veriore»), të cilin e kundërvinte me grupin lindor (ai e quante «gegërishte lindore») të nëndialektit verior të gegërishtes.³³

J. Gjinari, në pajtim me pikëpamjen e dytë të Lambercit, të folmen e Mirditës e përfshin në grupin perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes.³⁴

Ne, të folmen e Mirditës e kemi përfshirë në të folmet qendrore të gegërishtes (ne i kemi quajtur «të folmet e Gegërisë së Mesme»), të cilat simbas nesh përfshijnë të folmet e krahinave poshtë Drinit e deri në Malësinë e Tiranës e Martanesh, nga bregu i detit Adriatik e deri në afërsitë e Shkupit.³⁵

A.V. Desnickaja, në pajtim me ne, të folmen e Mirditës e përfshin në të folmet qendrore të gegërishtes të cilën ajo e quan «zona dialektore e mesme gege».

Duke krahasuar tiparet dalluese të parashtruara më sipër si karakteristike për të folmet e grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes me të dhënat e punimit tonë të pabotuar mbi të folmen e Mirditës, rezulton që shumica dërmuese e tipareve dalluese të këtij grupi të folmesh nuk janë karakteristike për të folmen e Mirditës.

1. Grupet e bashkëtingëlloreve *kl, gl*, që në të folmet perëndimore të nëndialektit verior të dialektit të veriut kanë dhënë respektivisht *kj, g-j*, në të folmen e Mirditës kanë dhënë respektivisht *q, gj*.

2. *a*-gojore e theksuar që ndodhet pranë bashkëtingëlloreve qiellzore-dhëmbore ose qiellzore, që në një numër të kufizuar fjalësh në të folmet perëndimore kalon në një *ç*, në të folmen e Mirditës ruhet.

3. forma me *-et* e rrjedhore së emrave të gjinisë femërore në funksionin e një plotësi të cilësisë, të shfarësisë e të lëndës në të folmen e Mirditës është tepër sporadike, me përjashtim të ekstremit veriperëndimor (Laç, Blinisht), ku paraqitet si ndikim i këtij grupi të folmesh. Atje është përgjithësuar forma me *-e* e kësaj trajte rasore.

4. Ndryshe nga të folmet perëndimore, ku është përgjithësuar mbaresa *-me*, për formimin e vetës së I-rë shumës të së kryerës së thjeshtë të mënyrës dëftore në të folmen e Mirditës është përgjithësuar mbaresa *-m*.

5. Ndryshe nga të folmet perëndimore, ku grupi i zanoreve *ae* ka kaluar me *ç*, në të folmen e Mirditës ose ruhet, ose kalon në *ae* (e-ja dëgjohet dobët) ose në *a*.

6. Ndryshe nga të folmet perëndimore, ku grupi i bashkëtingëlloreve *ngj* në një kategori fjalësh ka përfunduar në *nj*, në të folmen e Mirditës ka përfunduar në *gj'* ose *xh*.

32) M. Lambertz, *Bericht...* f. 9.

33) M. Lambertz, *Die Mundarten...* 1943, f. 129.

34) J. Gjinari, *Dialektologjia...* f. 76; *Sprovë*, f. 110.

35) B. Beci, *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të Gegërisë së Mesme*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor 1962)» Tiranë 1965, f. 261 (shih edhe hartën).

36) A. V. Desnickaja, *Albanskiy jazyk i evo dialekty*, Leningrad, 1968, f. 149.

7. Nuk është përgjithësuar në të folmen e Mirditës mbaresa *-(h)na*, karakteristike për të folmet e grupit perëndimor (krahas me *-(h)ena*).

Ndërsa në pjesën veriore, perëndimore e jugperëndimore të Mirditës ndeshet mbaresa *-(h)na*, në pjesën jugore dhe lindore mbaresa *-(h)mi*.

Të gjitha këto e përjashtojnë mundësinë e përfshirjes së të folmes së Mirditës në grupin perëndimor. E folmja e Mirditës ka edhe mjaft tipare specifike që e bashkojnë me të folmet qendrore të gegërishtes³⁷ dhe që e largojnë mjaft nga grupi perëndimor i nëndialektit verior të gegërishtes. Në këto rrethana bëhet e qartë që përfshirja e të folmes së Mirditës në një grup me të folmet perëndimore të nëndialektit verior nuk është reale.

Megjithatë duhet shënuar se në të folmen e pjesës veriperëndimore të Mirditës, që ndodhet në kufi me të folmet e grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes, kanë depërtuar edhe tipare të këtyre të folmeve, siç janë: 1) forma me *-et* e rrjedhore së emrave të gjinisë femërore në funksionin e një plotësi të cilësisë, të shfarësisë e të lëndës e cila është e përhapur në Laç e Blinisht; 2) formimi i vetës së parë shumë të së tashmes së dëftores së foljeve të diatezës pësore me anë të mbaresës *-(h)na*. Kjo mbaresë foljore ndeshet në Laç, Kaçinar, Koder — Spaç, Blinisht, Thirrë, Munaz, Fang.

Megjithatë duhet shënuar që edhe në territorin e të folmeve të pjesës veriperëndimore të Mirditës veçoritë dalluese të të folmeve qendrore të gegërishtes janë mbizotërueset.

Edhe lidhur me të folmen e Pukës, sikundër u tha, janë mbrojtur dy mendime të ndryshme.

J. Gjinari të folmen e Pukës e përfshin në grupin lindor³⁸, kurse A.V. Desnickaja në grupin perëndimor (duke përjashtuar të folmen e Berishës, Bugjonit, Iballes e Malit të Zi, të cilat simbas saj bëjnë pjesë në grupin lindor.³⁹

Duke krahasuar tiparet dalluese të parashtruara më sipër si karakteristike për të folmet e grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes me të dhënat e përimit ende të pabotuar të Xh. Topallit mbi të folmen e Pukës rezulton se në të folmen e krahinës së Pukës bashkëkzistojnë tipare dalluese të grupit perëndimor të nëndialektit verior me tipare dalluese të grupit lindor të këtij nëndialekti si edhe me tipare dalluese të të folmeve qendrore të gegërishtes.

Nga veçoritë dalluese të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes në të folmen e Pukës ndeshen këto:

1. Kalimi i një *a*-je gojore të theksuar që ndodhet pranë një bashkëtingëlloreje qiellzore-dhëmbore ose qiellzore në *ë* të hapët: *lerg*, *nel*, *mjëft*, *tësh*, *zërm*. Por krahas *e*-së dëgjohet mjaft edhe *a* te fjalët: *nalt*, *tash* dhe *mjaft*.

2. Reduktimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *ng* respektivisht në *m*, *η* : *majshem*, *mjell*, *nar*koj, *ηreh* etj.

3. Reduktimi i grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* në *sh* me mënyrën dëshirore të foljeve: *t'kosha* fal, *rrnosh*, *shkosha*.

4. Forma me *-et* e rrjedhore së emrave të gjinisë femërore me funksionin e një plotësi të cilësisë, të shfarësisë e të lëndës: vegshat i bajm prej *botet*, mish prej *lopet* etj.

37) B. Beci, *Mbi katër inovacione...*, f. 261-270.

38) J. Gjinari, *Sprovë...*, f. 110.

39) A. V. Desnickaja, *Albanski...*, f. 90, 112.

5. Formimi i vetës së parë shumë të së tashmes së dëftores të foljeve pësore me anë të mbaresës *-(h)na*: *bahna, çohna, martohna, ñyhna, kthehna* etj.

6) Formimi i trajtës së shquar të emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me bashkëtingëlloret *k, g* me anë të mbaresës *-u*. Kjo mbaresë është përgjithësuar në ish-elementin katolik, kurse në ish-elementin mysliman është përgjithësuar mbaresa *i*.

Nuk janë karakteristike për të folmen e krahinës së Pukës këto tipare dalluese të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes:

1. Kalimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *kl, gl*, në *kj, g-j*.
2. Reduktimi i grupit të zanoreve *ae* në *ç*.
3. Reduktimi i grupit të bashkëtingëlloreve *ngj* në *nj*.
4. Formimi i vetës së parë shumë të së kryerës së thjeshtë të foljeve veprare me anë të mbaresës *-me*.

Nga veçoritë dalluese të grupit lindor të nëndialektit verior të gegërishtes në të folmen e krahinës së Pukës ndeshen këto:

1. Grupet e zanoreve *ae, oe* po shkojnë drejt kontraktimit në *a* dhe *o*. Krahas *dhae, hae, lae, thae, voe* më shpesh dëgjojmë: *s'kan qā, ti dha, haja, vo, vnojm ro*. Ndonjëherë ndeshen edhe variantet ndërmjetës *ae, oe*.

2. Grupet e bashkëtingëlloreve *kl, gl* janë reduktuar respektivisht me *k, g*: *kaj, kumsht, kesh, ke, kem, guha, guni, goba* etj.

3. Trajta e shquar e emrave që mbarojnë me *k, g* në ish-elementin mysliman të krahinës formohet me anë të mbaresës *-i*: *beg-i, breg-i, prag-i, zog-i, çelik-i, mik-i, pjak-i*.

4. Formimi i trajtës aspektive të së tashmes me anë të foljes *jam*, pjesëz *ka* edhe kohës së tashme të foljes që mbart kuptimin kryesor (*s'jam ka tutem*). Kjo bashkekziston me trajtën aspektive të formuar nga folja *jam* dhe përcjellorja e foljes, që është karakteristike për të folmet perëndimore të nëndialektit verior dhe për të folme të tjera të gegërishtes.

E folmja e Pukës ka edhe tipare që janë karakteristike për të folmet qendrore të gegërishtes ose për një pjesë të tyre.

1. Grupi i bashkëtingëlloreve *ngj* është reduktuar në *ɣ*: *e xelpt, xeti, xyje*.

2. Grupet e bashkëtingëlloreve *bl, fl, pl* kanë përfunduar respektivisht në *bj, fj, pj*.

3. U-ja e theksuar është diftonguar në *ou* në disa nga fjalët me *u*: *poun, poushkt, touf, thoupër, kroue, martoue* etj.

4. *g*-ja është palatalizuar në *ɣ* në Kabash, Qelëz, Qerret dhe Pukë.

5. Grupet e bashkëtingëlloreve *tj, dj* janë palatalizuar respektivisht në *c, x* në Kabash, Qelëz, Qerret dhe Pukë.

Nga të gjitha këto, bëhet e qartë që në të folmen e krahinës së Pukës kanë depërtuar tipare të tre grupeve të të folmeve, pa qenë e mundur tani për tani të thuhet se cilat janë mbizotërueset.

Tani që pak a shumë janë përvijuar veçoritë më kryesore dalluese të të folmeve të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes mund të bëhet një argumentim i mëtejshëm edhe për vendin që zë e folmja e Nikaj-Mërturit.

E. Lafe, në punimin e tij mbi të folmen e Nikaj-Mërturit, me të drejtë shënon se «e folmja e Nikaj-Mërturit në shumicën e tipareve më të qenësishme që i ndajnë të folmet e Veriut (ka parasysh nëndialektin verior të gegërishtes B.B.) në lindore e perëndimore piqet me

grupin lindor dhe ndodhet gjeografikisht në brezin më perëndimor të atij grupi»⁴⁰.

Këtë pikëpamje të drejtë është përpjekur ta argumentojë duke zbuluar tiparet karakteristike të kësaj së folmeje të përbashkëta me grupin lindor të nëndialektit verior të gegërishtes dhe tiparet e përbashkëta të kësaj së folmeje me grupin perëndimor të këtij nëndialekti. Por këtu ka vend për saktësime e plotësime.

Nga tiparet e sjella prej E. Lafes si të përbashkëta me grupin lindor (ai e quan verilindor)⁴¹, simbas nesh qëndrojnë: 1. kalimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *kl, gl* në *k, g*; 2. formimi i së pakryerës në dy vetat e njëjësit me anë të mbaresave *shna, shne*.

Nga tiparet e sjella prej E. Lafes si të përbashkëta me grupin lindor (ai e quan verilindor), simbas nesh nuk qëndrojnë: 1. shndërrimi i zanores *a* para një bashkëtingëlloreje lindore në *ô, â*: *ôsht, jôm kaôn* etj.; 2. diftongimi i zanores *e* në *ie* në fjalë si (ti) *kë*: *kie; kije* (shumësi i kaut); 3. ndërrimi i *f*-së në *th* me fjalë si *thmi* për *fmi*; 4. depalatizimi i *m*zales *nj*: *n* te numërori *ni* «*nji*»; 5. përdorimi i foljes ndihmëse *jam* për të formuar kohët e përbëra të foljeve intransitive (sidomos të atyre që tregojnë lëvizje) p.sh. *jaom kaon, jaom shkue*.

Ne mendojmë se, përveç kalimit të grupeve të bashkëtingëlloreve *kl, gl* në *k, g* dhe formimit të së pakryerës në dy vetat e njëjësit me anë të mbaresave *-shna, -shne* (ne do të shtojmë edhe *-ke* për vetën e tretë), e folmja e Nikaj-Mërturit ka edhe të tjera tipare të përbashkëta me grupin lindor të nëndialektit verior të gegërishtes: 1. ruajtja e *a*-së gojore të theksuar që ndodhet pranë bashkëtingëlloreve qiellzore-dhëmbore ose qiellzore; 2. ruajtja e grupit të zanoreve *oe*. Duhet shënuar se në grupin lindor ky grup zanorësh ose ruhet ose reduktohet në *o* (kjo e fundit është më tipikja); 3. ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, ngj*. 4. formimi i rrjedhës njejës të emrave të gjinisë femërore me mbaresën *-e* dhe jo *-et*; 5. formimi i vetës së parë shumës të së kryerës së thjeshtë të dëftores së foljeve veprorë me anë të mbaresës *ëm(m)* dhe jo me anë të mbaresës *-me*, që ndeshet në grupin perëndimor.

Nga tiparet e sjella prej E. Lafes si të përbashkëta me grupin perëndimor (ai e quan veriperëndimor)⁴², si mbas nesh qëndrojnë: 1. kontraksioni i togut zanor *ae*: *e* te emri *nge*; 2. reduktimi i grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* me *sh* në mënyrën dëshirore të foljeve; 3. përdorimi i mbaresës *-u* (ai e quan nyjë e prapme) te emrat me *k, g* (*bujku, zogu*) dhe i mbaresës *-i* (ai e quan nyjë e prapme) te emrat me *-h* (*ahi, krahi*).

Nga tiparet e sjella prej E. Lafes si të përbashkëta me grupin perëndimor (ai e quan veriperëndimor), nuk qëndrojnë: 1. ndalimi i kontraksionit të grupit të zanoreve *ae* në *ë* te trajta foljore *pave*; 2. asimilimi i grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* në *sh* në raste të tjera përveç dëshirores së foljeve.

Nuk qëndron as pohimi që grupi i zanoreve *oe* në grupin perëndimor (ai e quan veriperëndimor) është kontraktuar në *ô*.

Nga të gjitha këto del e qartë që në të folmen e Nikaj-Mërturit kanë depërtuar tipare të grupit perëndimor dhe tipare të grupit lindor të nëndialektit verior dhe se këto të fundit janë mbizotërueset.

40) E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit...*, f. 136.

41) E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit...*, f. 135-136.

42) E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit...*, f. 136.

Si përfundim, do të themi që të folmet e Nikaj-Mërturit, të krahinës së Pukës, të pjesës veriperëndimore të Mirditës përbëjnë një shirit rrethues të të folmeve perëndimore, shirit që karakterizohet nga një gërshetim i tipareve karakteristike të këtij grupi të folmesh dhe të grupeve për rreth. Nga sa u tha më sipër, del e qartë se shkalla e gërshetimit të tipareve dalluese të të folmeve të grupit perëndimor me ato të grupeve për rreth nuk është e barabartë në këto të folme.

Në të folmen e Nikaj-Mërturit mbizotërojnë tiparet e grupit lindor të nëndialektit verior të gegërishtes kurse në të folmen e pjesës veriperëndimore të Mirditës mbizotërojnë tiparet e të folmeve qendrore të gegërishtes.

Në këto rrethana e folmja e Nikaj-Mërturit duhet konsideruar si një e folme lindore me disa tipare të grupit perëndimor, kurse e folmja e pjesës veriperëndimore të Mirditës si një e folme qendrore e gegërishtes me disa tipare të grupit perëndimor të nëndialektit verior të gegërishtes.

Përsa i përket së folmes së krahinës së Pukës, duhet pranuar, se është vështirë të thuhet se tiparet e cilit grup janë mbizotëruese, gjë që na shtyn që të folmen e kësaj krahine ta shikojmë si një të folme të ndërmjetme në mes të grupeve të të folmeve të nëndialektit verior dhe të folmeve qendrore të gegërishtes.⁴³

Megjithatë duhet theksuar se tiparet dalluese të të dy grupeve të të folmeve të nëndialektit verior dhe tiparet e të folmeve qendrore të gegërishtes nuk janë barabar të përhapura në territorin e të folmes së krahinës së Pukës.

Do të duhen studime të mëtejshme për të përcaktuar me saktësi shtrirjen territoriale në të folmen e krahinës së Pukës të tipareve dalluese të grupeve të të folmeve të nëndialektit verior dhe të të folmeve qendrore të gegërishtes.

R é s u m é

LE GROUPE OCCIDENTAL DU SOUSDIALECTE SEPTENTRIONAL

DU GUEGUE

(Particularités distinctives)

L'auteur aborde deux questions: 1. l'extension territoriale du «groupe occidental du sousdialecte septentrional du guègue», qui se trouve dans la partie N.-O. de l'Albanie et qui comprend surtout les parlers du district de Shkodër; 2. ses particularités distinctives dans les domaines de la phonétique et de la morphologie.

L'auteur, dans cet article, fait une nouvelle lumière sur ces questions, en se basant sur les nouveaux matériaux glanés et sur les études faites de ces parlers. Ne sont pas traités les particularités lexicales et syntaxiques, du fait que les matériaux glanés à cette fin sont encore insuffisants.

Dans la première partie de son exposé, l'auteur soumet à analyse critique les opinions exprimées sur l'extension territoriale de ce groupe de parlers par

43) Për nocionin «të folme të ndërmjeme» ashtu siç e kuptojmë ne këtë koncept shih B. Beci, *Rreth nocionit «e folme kalimtare» në gjuhën shqipe*, Buletin shkencor, 1967, 6, f. 219-229.

M. Lambertz, J. Gjinari et A.V. Desnitskaya. Il soutient que pour argumenter dûment l'extension territoriale d'un groupe de parlers, il est nécessaire d'établir tout d'abord ses particularités distinctives et son extension territoriale.

Dans la deuxième partie de l'article, l'auteur esquisse l'état des études et les principales opinions avancées sur les particularités de ce groupe de parlers par des auteurs comme N. Jokl, E. Çabej, J. Gjinari, E. Lafe.

D'après Beci, dans les travaux des auteurs en question ont été exprimées des opinions sur les particularités distinctives de ce groupe de parlers, mais qu'il leur ont manqué presque complètement les données effectives à argumenter leurs opinions. Cela a porté ces auteurs, souvent, à des affirmations non parfaitement exactes ou bien même dénuées de toute base.

Des particularités de ce groupe de parlers, que les auteurs en question ont considéré comme caractéristiques, sont valables d'après Beci:

1. Le passage du groupe de consonnes *kl, gl* respectivement en *k-j, g-j*: *kjumsht, g-jun*.

2. Le passage du groupe de voyelles *ae* en *ε* (ouvert): *s'ka ηε, hε*.

3. L'aboutissement en *sh* du groupe de consonnes *fsh* au mode désidératif des verbes à radical en voyelle: *rrnosh, kjoshi*.

4. La forme à *-et* de l'ablatif des noms féminins en fonction d'un complément de qualité, de spécification, de matière: *mish lopet, buk theknet*.

Beci argumente son opinion que ces traits sont valables à différencier ces parlers par des données suffisantes tirées des parlers de ce groupe.

Des particularités évoquées par les auteurs en question comme étant caractéristiques à ce groupe de parlers, ne résistent pas, selon Beci, ou bien ne sont pas dûment définies, les suivantes:

1. L'affirmation que le groupe de voyelles *α* a donné *ö* (*α*) dans ce groupe de parlers.

2. L'affirmation que, «outre Shkodër, où *ue, ye, ie* ont été monophthongués, dans plusieurs parlers de ce groupe on trouve actuellement des groupes de voyelles *ue, ye, ie* et surtout davantage en syllabe finale ouverte». Au contraire, l'auteur soutient qu'on ne peut pas admettre l'estimation d'un état comme un trait distinctif de ce groupe de parlers. D'après lui, dans le sousgroupe N. de ces parlers, ces groupes de voyelles sont conservés, dans la plupart des parlers, non monophthongués. Au contraire, dans le groupe S., ces groupes sont monophthongués respectivement en *u, y, i*.

3. L'affirmation que le groupe de consonnes *fsh* produit *sh* dans ce groupe de parlers. D'après l'auteur, il ne s'agit que du *fsh* du mode désidératif des verbes, mais qu'elle ne résiste pas pour les autres *fsh*.

4. La prétention que dans le groupe occidental du sousdialecte septentrional du guègue, les groupes de consonnes *mb, nd, ng*, sont assimilés respectivement en consonnes quelque peu bruyantes: $\bar{m}, \bar{n}, \bar{h}$. Ces groupes de consonnes, dans ce groupement de parlers, ont subi, d'après l'auteur, des évolutions doubles et triples. Dans tous les parlers de ce groupe se sont étendus les passages de *mb* en *m* et de *ng* en *η*. Dans les parlers de la partie N. de ce groupe, à côté de ces évolutions, sont observées aussi celles $mb \rightarrow b(p), nd \rightarrow n, nd \rightarrow d(t), ng \rightarrow g(k)$, tandis que dans les parlers de la partie S. de ce groupe on a $nd \rightarrow \bar{n}$.

Toutes ces contestations que Beci fait aux auteurs en question sont argumentées par des données effectives de ces parlers.

Aux particularités distinctives admises par lui pour ce groupe de parlers, Beci ajoute aussi d'autres qui n'ont pas été mises en évidence jusqu'à présent, ou bien qui ont été caractéristiques au sousdialecte septentrional, mais qui ne le sont pas:

1. Le passage d'un *a* buccal accentué, habituellement en syllabe fermée, en

proximité de consonnes palatales-dentales ou palatales en un *ɛ* ouvert dans un petit nombre de mots: *təsh*, *nəlt*.

2. La désinence *-me* de la première personne au pluriel du passé simple de tous les verbes actifs.

3. La seule existence de la désinence *-h-ena* (*-h-na*) pour la forme de la première personne pluriel du présent indicatif des verbes de la diathèse passive.

Ces particularités aussi ont été argumentées par Beci au moyen de données suffisantes tirées de ces parlars.

Beci, voulant fixer la valeur de ces traits pour la différenciation de ces parlars, fait noter pourtant qu'elles n'ont pas la même valeur.

1. Une valeur absolue à isoler ce groupe de parlars de tous les autres groupes de parlars des sousdialectes du guègue a le passage du *kl*, *gl* respectivement en *k-j*, *g-j*: *kjumshi*, *g-juh*.

2. Ont une valeur absolue à isoler ce groupe de parlars des autres groupes de parlars des sousdialectes du guègue et une valeur relative à l'isoler du groupe oriental, le sous-dialecte N. du guègue, les particularités suivantes: a) le passage d'un *a* buccal accentué, habituellement en syllabe fermée, à côté des consonnes palatales-dentales ou dentales en *ɛ* ouvert dans un petit nombre de mots: *təsh*, *prəp*; b) la réduction du groupe de consonnes *fsh* en *sh* au mode désidératif des verbes à thème en voyelle; c) la formation à l'aide de la désinence *-et* de l'ablatif singulier des noms féminins en fonction d'un complément de qualité, de spécification, de lieu; ç) la formation à l'aide de la désinence *-me*, de la première personne du singulier du passé simple de tous les verbes.

3. Ont une valeur relative à isoler ce groupe de parlars des autres groupes des sousdialectes du guègue et une valeur absolue à l'isoler du groupe oriental du sousdialecte septentrional du guègue: a) l'assimilation du groupe des consonnes *ngj* en *nj* dans une catégorie donnée de mots, qui dans la langue littéraire sont écrits en *ngj*; b) la formation de la forme aspective du présent au moyen du verbe *jam* et du gérondif des principaux verbes: *jam tu çu*.

4. Ont une valeur relative à isoler ce troupe de parler des autres groupes de parlars des sousdialectes du guègue (y compris aussi le groupe oriental du sousdialecte septentrional du guègue): a) la réduction de voyelles *ae* en *ɛ*; b) la réduction de groupe de consonnes *mb*, *ng* respectivement en *m*, *ŋ*, dans une catégorie donnée de mots qui en langue littéraire résultent en *mb*, *ng*; c) la formation de la première personne du pluriel du présent indicatif des verbes de la diathèse passive à l'aide de la désinence *-h-ena* (*h-na*).

5. Une valeur relative à isoler ce groupe de parlars du groupe oriental du sousdialecte septentrional du guègue a la formation du défini des noms masculins se terminant par *k*, *g* à l'aide de la désinence *-u*.

Dans la troisième partie de l'exposé, Beci établit l'extension territoriale de ce groupe de parlars, en l'argumentant par des données suffisantes.

L'auteur trouve insoutenable le point de vue d'après lequel le parler de la Mirdite appartient au groupe occidental du sousdialecte septentrional du guègue. Il soutient, arguments à l'appui, que dans le parler de Puke ont pénétré des traits des trois groupes de parlars sans qu'il soit possible à affirmer quels soient prédominants. Cela a porté l'auteur à considérer le parler de cette région comme un parler transitoire entre les groupes de parlars du sousdialecte septentrional et des parlars centraux du guègue.

L'auteur fait un effort à argumenter plus loin la place qui revient au parler de Nikaj-Mértur. Il aboutit à la conclusion que dans ce parler ont pénétré des traits du groupe occidental et oriental du sousdialecte septentrional et que ces derniers prédominent dans ces parlars. Cela a porté l'auteur à conclure que ce parler est un parler oriental à influences du groupe occidental.

